



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

K.DH.SH.II.nr.1021/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Krenar Berisha dhe Ramush Bardiqi anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Arena Trade” Sh.P.K me seli në Fushë Kosovë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.133/19, të datës 30.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.06.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit “Arena Trade” Sh.P.K me seli në Fushë Kosovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.133/19, i datës 26.04.2021 **ANULOHET**, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me Aktgjykimin e ankimuar e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit-subjektit, “Arena Trade” Sh.P.K me seli në Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat S.E. nga Shoqëria e Avokatëve “Vokshi&Lata” Sh.P.K, ka lënë në fuqi aktvendimin nr. 01.3.2.2/686 të datës 13.12.2018 të Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi ka parashtruar ankesë paditësi, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar gjykatës që të aprovet si e bazuar ankesa e paditësit “Arena Trade” Sh.P.K, të Ndryshohet Aktgjykimi A.nr.133/19 i datës 26.04.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative. Aprovet kërkesëpadia e paditësit “Arena Trade” Sh.P.K Anulohet aktvendimi i të paditurës Dogana e Kosovës Nr. 01.3.2.2/686 i datës 13.12.2018. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës që paditësit “Arena Trade” Sh.P.K t’ia pranoj vlerën e transaksionit realisht të paguar për mallin lëndor sipas DUD-it R-24132 të datës 17.10.2018 dhe t’ia kthej mjetet e paguara më tepër paditësit në emër të taksave doganore importuese në vlerë 1,972.50€ me kamatë vjetore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë në Gjykatë me datë 14.01.2019 e deri në pagesën definitive, ose të Prishtet

Aktgjykimi i atakuar A.nr.133/19 i datës 05.05.2021 dhe çështja t'i kthehet në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë, përgjigjes në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

- Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin, e organit të paditur Dogana e Kosovës, nr. 01.3.2.2/686 të datës 13.12.2018, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë "Arena Trade" Sh.P.K - Fushë Kosovë, për rishqyrtimin e vendimit R-24132/17.10.2018 të Zyrës së Brendshme Doganore Intereuropa, si e pa bazuar.

Kundër aktvendimit të cekur të paditurës, subjekti tani paditësi, me padi fillon konfliktin Administrativ në procedurë gjyqësore. Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit publik, në praninë e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit e në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, të datës 26.04.2021, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e atakuar ka konkluduar se e paditura rivlerësimin e mallit e ka bërë pasi që ka gjetur se vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë dhe se Dogana disponon me të dhëna të disponueshme që vlera e mallit lëndor kontestues është më e lartë se vlera e deklaruar nga subjekti andaj ka caktuar vlerë të re bazuar në të dhënat e disponueshme, përkatësisht çmimet të cilat janë marrë nga reuters siç mime të bursës në kohën e blerjes së mallrave, gjithashtu nuk ka paraqitur dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar se vlera e deklaruar është vlerë reale e transksionit. Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi janë kundërthënëse dhe si të tilla nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Kolegji i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelle esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n).

Dhomat e Shkallës së Dytë të kësaj gjykate duke vlerësuar pretendimet ankimore gjen se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje esenciale pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare, respektivisht arsyet janë të paqarta dhe kontradiktore. Sipas vlerësimit të Kolegjit qëndron fakti se paditësja vlerën e transaksionit sipas urdhër pagesës e ka bërë në shumë prej 40,032.00 € dhe kjo shumë është paguar bazuar në pro-faturë 209/10 e cila i referohet shumës së njëjtë prej 40,032.00 €. Ndërkaq vlera e deklaruar në DUD-in kontestues prej 38,999.20 i referohet shumës më pak të paguar sesa shuma e transaksionit sipas faturës br.210/10 të datës 15.10.2018.

Sipas vlerësimit të Kolegjit, lidhur me çmimin e deklaruar të mallit lëndor ka një harmonizim të plotë ndërmjet çmimit/kg të deklaruar në kontratën e shitblerjes së mallit lëndor, me çmimin/kg të deklaruar në pro-faturë dhe çmimit/kg të paguar, ndërkaq çmimi në faturë rezulton më i ulët sesa ai realisht i paguar. Në secilin import, çmimi/kg i deklaruar në kontratën e shitblerjes në pro faturë dhe faturë janë të njëjta dhe rrjedhimisht ka harmonizim të plotë. Sipas provave të paraqitura nga paditësi rezulton fakti se paditësi ka paraqitur transaksionin bankar duke përshkruar edhe numrin e pro faturave për mallin lëndor në pagës për mallin lëndor i cili dëshmon çmimin e blerjes realisht të paguar për mallin lëndor.

Kolegji i kësaj gjykate pasi ka analizuar transaksionin bankar dhe faturën e mallit lëndor kontestues, konstaton se transferi bankar është bërë në emër dhe llogari të eksportuesit të mallit “DOO DND COMP”, ku përmes të dhënave bankare të eksportuesit të paraqitura në faturë është bërë edhe transfari bankar i datës 10.10.2018, ndërsa në përshkrimin e transferit është shënuar numri i pro-faturës nr.209/10 që përfshin mallin lëndor kontestues. Ndërsa pretendimi i të paditurës se dokumentacioni përcjellës i mallit është i pa mjaftueshëm pasi që nuk është prezantuar deklarata eksportuese, nuk qëndron pasi që deklarata eksportuese nuk është dokument i cili kërkohet sipas Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës dhe nuk është dokument i obligueshëm, ndërsa gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit ka konstatuar se ka mos harmonizim mes dokumenteve përcjellëse të mallit dhe nuk ka mundur të siguroj informata të mjaftueshme se është bërë transferi bankar pikërisht për këtë faturë përcjellëse të mallit.

Dhomat e Shkallës së Dytë kanë shqyrtuar shkresat e lëndës dhe ka gjetur se transferet bankare përmbajnë numrin identifikues të mallit që gjendet i shënuar në profaturat përcjellëse të mallit, dhe këto transfere janë të harmonizuara si në kuptim të shumës ashtu edhe në kuptim të përshkrimit me faturat e mallit lëndor kontestues. Ndonëse në faturën e prezentuar të datës 15.10.2018 evidentohet shuma prej 38,999.20 € e cila është më e ulët sesa ajo që i referohet profaturës dhe transaksionit, është evident fakti se një gjendje e tillë përcakton se fatura paraqet çmim më të ulët sesa çmimi real i paguar. Në anën tjetër, Dhomat e Shkallës së dytë tani për tani nuk mund të pajtohen me qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për faktin se hulumtimi dhe analizimi i të paditurës për mallrat e njëjta dhe të ngjashëm të zhdoganuar nga Dogana e Kosovës i referohen DUD-ave të cilat nuk kanë të bëjnë me mallin e njëjtë, pasi që nga shkresat e lëndës paditësja ka importuar mall me përshkrimin “old crob”, ndërkaq DUD-at krahasues i referohen cilësisë së mallit “first class”.

Andaj mbi këtë bazë e paditura ka aplikuar në mënyrë të gabuar nenin 35 përkatësisht metodën e 6 të vlerësimit sipas KDA-së, pasi që paditësi ka poseduar të gjitha dokumentet e transaksionit të harmonizuara në kuptim të vlerës dhe se nga e paditura nuk është prezantuar asnjë provë e cila do të dëshmonte se paditësi ka paguar më shumë se fatura në emër të mallit.

Prandaj, kjo gjykatë tani për tani nuk mund të pranoj si të drejtë një konstatim të tillë të paraqitur në aktgjykimin e ankimuar, sepse ka të meta për të cilat nuk mund të ekzaminohet, dhe se është juridikisht i paqartë dhe i paqëndrueshëm.

Për arsyet e lartcekura, aktgjykimi i kundërshtuar është dashtë të anulohet dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, për t’i eliminuar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të theksuara më lartë, që janë të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktgjykimin të kontestuar.

Gjykata e shkallës së parë, në ri procedurë, duhet të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit kontestues me nr. 01.3.2.2/686 të datës 13.12.2018 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, vendim i marrë nga e paditura, e që është objekt shqyrtimi në këtë çështje juridike. Gjykata e shkallës së parë, duhet t’i shqyrtojë të gjitha vërejtjet e dhëna nga kolegji i kësaj gjykate, t’i eliminoj të gjitha shkeljet e theksuara më lartë, të vendos në kuptim të nenit 160 të LPK-së, ashtu që të vërteton faktin se lidhur me DUD-at kontestues – e paditura a ka mundur t’i siguroj të dhënat e disponueshme për mallin e ngjashëm “old crob” dhe jo atë të vlerësuar nga e paditura. Pas vlerësimit dhe analizimit të provave dhe çmimit realisht të paguar gjykata e shkallës së parë duhet që në mënyrë të drejtë të zbatoj të drejtën materiale, në vlerësimin e ligjshmërisë së nxjerrjes së vendimit të paditurës gjatë procedurës administrative, konform nenit 43 të LKA -së, dhe mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, të sjell një vendim të ligjshëm dhe të drejtë, dhe një dispozitiv të qartë, të kuptueshëm dhe të përmbarueshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1021/22, me datë 20.06.2023

Kryetar i kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova